



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regionale Kompanija za Uklanjanje Otpada

"PASTRIMI" sh.a. d.d.

Nr.br. 2486 dt. 01.07.2022

Prishtine - Prishtina

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

01 Nr.Br. 345/01-34596

Data/Datum, 01.07.2022



KOMPANIA REGJIONALE PASTRIMI

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur ndërmjet:

1. Komuna e Lipjanit, në tekstin vijues "Komuna" të cilën e përfaqëson, Kryetari i Komunës z. Imri Ahmeti,

2. KRM "Pastrimi" SH.A.-Prishtinë, në tekstin vijues "Kompania" të cilën e përfaqëson z. Burim Kelmendi, Kryeshef Ekzekutiv, si vijon:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është dhënie në shfrytëzim të një kamioni VARIOPRESS 308s/n no. 535620 Mercedes Benz-chassis type Atego 1524 L4x2 NO VV1T96702710568735, KRM "Pastrimi" SH.A.-Prishtinë nga Komuna e Lipjanit, kamion i fituar si donacion nga GIZ Gjerman sipas Marrëveshjes Nr.1-400/01-33719 të datës 28.06.2022 të lidhur ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe GIZ Gjerman. Komuna Lipjanit edhe pas dhënies në shfrytëzim të kamionit për KRM "Pastrimi" Sh.A, mbetet pronare e kamionit të cekur në këtë nenë ndërsa KRM "Pastrimi" Sh.A është shfrytëzese e përkohëshme e kamionit.

Neni 2

Obligimet e Komunës

Komuna Lipjanit me këtë Marrëveshje obligohet të i jep në shfrytëzim kamionin e cekur në nenin 1, KRM "Pastrimi" Sh.A.-Prishtinë me të drejtë të shfrytëzimit për nevojat e kompanis për kryerjen e shërbimeve efikase për qytetarët e Komunës së Lipjanit.

Neni 3
Obligimet e Kompanisë "Pastrimi" Sh. A Prishtinë

KRM "Pastrimi" Sh.A.-Prishtinë obligohet të marrë në shfrytëzim komionin e cekur në nenin 1 të kësaj Marrëveshje, për kryerjen e shërbimeve efikase për qytetarët e Komunës së Lipjanit, po ashtu procedurat për regjistrimin e kamionit në mënyrë që të ketë të drejtën e qarkullimit i bartë KRM "Pastrimi" SH.A.-Prishtinë. KRM "Pastrimi" obligohet të kujdeset për asetin/komionin të dhënë në shfrytëzim nga Komuna e Lipjanit për të gjitha defektet e mundshme si dhe t'i kryej me rregull servisimet e kamionit.

Neni 4
Ndryshimi dhe Përfundimi

1. Kjo Marrëveshje bashkëpunimi mund të ndryshohet vetem me shkrim.
2. Kjo Marrëveshje bashkëpunimi mund të jetë zgjidhur nga çdo palë me kushtin që të njoftojë palën tjetër me shkrim 30 (tridhjetë) ditë përpara.

Neni 5
Hyrja në fuqi

1. Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.
2. Marrëveshja është hartuar në dy (2) kopje identike origjinale dhe secila nga palët marrin nga një (1) kopje.

Nënshkruar:

Kryetar i Komunës së Lipjanit
Z. Imri Ahmeti



Kryeshf Ekzekutiv KRM "Pastrimi"SH.A.-
Z. Burim Kelmendi

